



DONACIONI NGA TAKSAPAGUESIT PËR FËMIJËT NGA SHTËPIJA E FOSHNAVE DHE FËMIJËVE TË VEGJËL NË MANASTIR

Aksioni tradicional humanitar nën moton “Bëhu njerëzor, bëhu human” u realizua edhe këtë vit në kuadër të programit për shënimin e Shën Mateut – Ditës së punonjësve tatimor. Punonjësit e Drejtorisë së të hyrave publike tradisionalisht çdo vit dhurojnë para nga të cilat më pas blihen produkte dhe u dhurohen kategorive të rrezikuara të qytetarëve. Drejtoresha e DHP-së Sanja Lukarevska, këtë vit në emër të punonjësve të Drejtorisë së të hyrave publike ndau donacion për IP-në Shtëpinë e Foshnave dhe Fëmijëve të vegjël në Manastir. Donacioni është siguruar përmes organizatës sindikale “Solidariteti”, gjegjësisht të gjitha mjetet janë siguruar nga punonjësit.

“Si qytetarë të përgjegjshëm shoqërorë, por edhe si taksapagues, ne gjithmonë ndihmojmë aty ku është më e nevojshme. Për këtë institucion, në kuadër të donacionit, kemi marrë gjithçka që i nevojitet: krevat fëmijesh, batanije, shتروje, vitamina dhe shumë produkte të tjera të nevojshme. Edhe pse mendoj se fëmijëve u nevojitet një buzëqeshje e ngrohtë. Në të ardhmen do të vazhdojmë me të njëjtin ritëm, sepse duhet ta ruajmë traditën dhe këtë e bëjmë në prag të çdo festë, ditës së punonjësve tatimor “Shën Mateut”. Jam krenare që drejtoj një institucion i cili në rradhë të parë i përgjegjshëm shoqëror” – theksoi Lukarevska.

Donacioni u pranua nga U.D drejtoresha e Institucionit publik “Shtëpia për foshnja dhe fëmijë të vegjël në Manastir”, Aneta Talevska, e cila i dorëzoi Mirënjojhe drejtoreshës së DHP-së dhe punonjësve.

“Faleminderit shumë për mbështetjen nga një institucion kaq të rëndësishëm – Drejtorisë së të hyrave publike, e cila me donacionin e saj kontribuojnë pasurimin e cilësisë së jetës së fëmijëve në Institucion në aspektin e përkujdesit, të ushqyerit, kujdesit shëndetësor dhe stimulimit për zhvillim të duhur psikomotorik”. - tha Aneta Talevska, drejtoreshë e IP-së Shtëpia për Foshnjat dhe Fëmijët në Manastir.

Shtëpia e foshnjava dhe fëmijëve të vegjël në Manastir është themeluar në vitin 1971. Institucioni kujdeset, ofron kujdes, ushqyerje dhe stimulim përfshi foshnjat dhe fëmijët e vegjël si dhe fëmijët me nevoja të veçanta. Ai kujdeset përfshi prindërit e mitur me fëmijët e strehon përkohësisht gra të vetme shtatzëna një muaj para lindjes dhe prindërit të vetëm derisa fëmija të jetë tre muajsh.